

## TERMAT E REFERENCËS

<b>Emri i projektit</b>	“Mbështetja e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara drejt jetesës së pavarur dhe ngritja e mirëqenies së tyre” Projekt i implementuar nga HANDIKOS dhe financuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
<b>Lloji i angazhimit</b>	Vozitës
<b>Lokacioni</b>	Prishtinë
<b>Orari i punës</b>	Orar të plotë
<b>Kohëzgjatja</b>	Gusht – Dhjetor 2022
<b>Data e pritshme e fillimit</b>	1 Gusht 2022
<b>Raporton tek</b>	Menaxheri/ja i/e projektit

### 1. HYRJJE

Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës (tani e tutje HANDIKOS), është organizatë jo-qeveritare e zhvillimit shoqëror, e themeluar në vitin 1983, duke synuar arritjen e njohjes dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara (PAK) në shoqëri. HANDIKOS mbron në mënyrë aktive në nivel lokal dhe qendror të drejtat e PAK, duke synuar krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës përmes rritjes së mundësive të punësimit; përmirësimin e qasjes në edukim, mirëqenie sociale dhe skemave të mbrojtjes sociale; dhe përmirësimin e qasjes fizike.

#### 1.1 KONTEKSTI I PROGRAMIT

HANDIKOS është duke implementuar projektin “Mbështetja e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara drejt jetesës së pavarur dhe ngritja e mirëqenies së tyre”, i cili financohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Përmes këtij projekti HANDIKOS synon të mbështesë zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe në mirëqenien e tyre dhe familjes përmes shërbimeve multidisciplinare të qëndrimit ditor dhe bashkëveprimit ndërsektorial.

Në kuadër të këtij projekti, me qëllim të avancimit të zhvillimit dhe ruajtjes së mirëqenjes; HANDIKOS është në kërkim të punësimit të një vozitës me orar të plotë të punës.

### 2. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME E POZITËS

Vozitësi do të jetë përgjegjës për transportimin e fëmijëve nga pikat e caktuara në qendër dhe anasjelltas. bënë në vende të ndryshme di dhe punë të tjera.

#### 2.1 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Bartja e fëmijëve nga pikat e caktuara deri në qendër dhe anasjelltas;
- Pranon dhe përcjell porositë dhe dërgesat;
- Punë të tjera të ngjajshme lidhur me pozitën sipas kërkesave dhe nevojave të Organizatës

## 2.2 NJOHURITË & PËRVOJA:

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Përvojë paraprake pune në pozita të ngjashme (e preferuar)
- Shkathtësi të mira të komunikimit dhe organizimit;
- Qasje gjithëpërfshirëse ndaj aftësisë së kufizuar;
- Të ketë patent shoferi. kategoria B

## 2.3 DOKUMENTET PËR APLIKIM:

- Curriculum Vitae (CV);
- Letër e motivimit që argumenton përshtatshmërinë e kandidatit me pozitën e hapur;
- Kopjen e diplomës së nivelit më të lartë të edukimit (në rast të përzgjedhjes);
- Çertifikatën që dëshmon se kandidati nuk është nën hetime (në rast të përzgjedhjes);

***Kandidatët e interesuar ftohen të dorëzojnë CV-në, letrën e motivimit, kopjen e diplomës; dhe referencat në: [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org)***

***Ju lutemi që ta cekni në titull: “Aplikim- Vozitës”***

***Do të kontaktohen vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë.***

***Afati për aplikim: 3 Qershor, 2022, deri në orën 23:59.***

***HANDIKOS është i përkushtuar për barazi gjinore dhe diversitet, dhe të ketë një ekip që përbëhet nga shkathtësi, përvoja dhe aftësi të ndryshme. Ne e inkurajojmë aplikimin e kandidatëve me prejardhje të ndryshme, dhe nga komunitetet dhe sektorët e ndryshëm.***

**Për informata shtesë lidhur me HANDIKOS, shih [www.handi-kos.org](http://www.handi-kos.org)**